

2019



BAROMETRI I SIGURISË SHQIPËRI ANKETË KOMBËTARE



Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes



Barometri i Sigurisë Shqipëri Anketë Kombëtare 2019

Autor

Arjan Dyrmishi

Metodologjist

Eduard Zaloshnja

Përpunimi i të dhënave

Alaattin OZDE, Albelite Design

Parathënie

Stine Klapper, Director of the Friedrich Ebert Stiftung, Tirana Office

Dizajni grafik

Ergys Temali

Anketuesit në terren

Agnie Konomi, Andi Hoxhallari, Arjana Kola, Behie Alushi, Elida Balla, Dallandyshe Kallaverja, Besjana Paftali, Çlirim Shehu, Hekuran Sula, Irma Çoku, Irena Llambi, Juljan Alija, Jorida Haznedari, Marinela Hoxha, Marsida Likrama, Nezir Prendi, Leonora Cela, Luljeta Manaj, Liljana Take, Lindita Pirani, Rajmonda Nushi, Sami Meçollari, Silva Mihali, Sonila Prushi, Sofie Bici, Vjollca Gjini, Vjollca Behluli, Xhuljana Idrizi.

Mirënjohje

Ky edicion i parë i Barometrit të Sigurisë Shqipëri është bërë i mundur vetëm me anën e suportit të Fondacionit Friedrich-Ebert, Zyra Tiranë. Një mirënjohje e veçantë u duhet akorduar anketuesve në terren për performancën e tyre profesionale dhe kontributin thelbësor që ata kanë dhënë për mbledhjen e të dhënave.

Të drejtat e autorit

© Të tëra të drejtat e rezervuara për Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG). Asnjë pjesë e këtij studimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem ruajtje të dhënash, ose të transmetohet, në mënyrë, elektronike, mekanike apo çfarëdo forme tjetër, pa cituar Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG).

Për Dijeni

Analizat e prezantuara në këtë raport reflektojnë vetëm perceptimet e njerëzve të ndryshëm dhe nuk mund të jenë në asnjë mënyrë një vlerësim përfundimtar i cilësisë së punës dhe performancës së institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në të.

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Friedrich Ebert Stiftung (FES).

Lista e shkurtimeve

ASB	Barometri i Sigurisë Shqipëri
CSDG	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
BE	Bashkimi European
FES	Friedrich-Ebert-Stiftung
INSTAT	Instituti i Statistikave, institucioni zyrtar i Shqipërisë për statistikat
ISIS	Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MB	Ministria e Punëve të Brendshme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NGO	Organizata Jo-Qeveritare
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit

Përmbajtja

Lista e Shkurtimeve.....	5
Përmbajtja	6
Lista e Grafikëve:	7
Parathënie	11
Hyrje	13
Metodologjia	16
Pyetësi	16
Kampioni.....	16
Mbledhja dhe Analiza e të Dhënave	17
Gjetjet kryesore.....	19
1. Informacion Demografik	21
2.Perceptime rreth kërcënimeve individuale dhe komunitare të sigurisë.....	23
2. Kënaqja me sigurinë dhe opinionin lidhur me qasjet për përmirësimin e sigurisë	32
3.Perceptime rreth sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare	41
4. Perceptime rreth ndikimit ndaj sigurisë nga aktorë të huaj.....	47
Vendet më miqësore	47
Ndikimi i jashtëm	49
Ndikimi i “aktorëve të tretë”	52
5. Integrimi në BE dhe perceptimi rreth prioriteteve kyçe	54
6. Perceptimi i besimit dhe integritetit të institucioneve të sigurisë.....	66
Besimi në institucionet e sigurisë	66
Korrupsioni në sektorin e sigurisë.....	71
Aneksi 1 – Pyetësi	74
Aneksi 2 – Shpërndarja e kampionit midis 61 bashkive	88

Lista e grafikëve

Grafik 1. Moshat e të anketuarve

Grafik 2. Niveli i arsimit i të të anketuarve

Grafik 3. Profesioni i të anketuarve

Grafik 4. Rezultate lidhur me perceptimin e sigurisë në vendbanim rural/suburban

Grafik 5. Rezultate lidhur me perceptimin e sigurisë në vendin e punës rural/suburban

Grafik 6. Rezultate lidhur me perceptimin e sigurisë në vendin e punës/banimit për të dy gjinitë

Grafik 7. Rezultatet mbi perceptimin e kërcënimit numër një dhe numër dy për sigurinë personale

Grafik 8. Rezultatet mbi perceptimin e kërcënimit numër një dhe numër dy ndarë sipas të dy llojeve të vendbanimeve

Grafik 9. Rezultatet mbi perceptimin e kërcënimit numër një dhe numër dy ndarë sipas të dy gjinive

Grafik 10. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me situatën e sigurisë

Grafik 11. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me bashkëpunimin midis pushtetit vendor-policiës për sigurinë

Grafik 12. Rezultatet mbi subjektin më të rëndësishëm për garantimin e sigurisë

Grafik 13. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me prezencën e policisë në lagje/fshat

Grafik 14. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me prezencën e policisë në zona rurale/suburbane në krahasim me zonat urbane

Grafik 15. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të prezencës policisë me nivelin e sigurisë

Grafik 16. Rezultatet mbi pritshmëritë e përmirësimit të policisë nga modernizimi

Grafik 17. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të prezencës policisë me nivelin e sigurisë ndarë sipas dy llojeve të vendbanimeve

Grafik 18. Rezultatet mbi pritshmëritë e përmirësimit të policisë nga modernizimi i ndarë sipas dy llojeve të vendbanimeve

Grafik 19. Rezultatet mbi perceptimin e masave të cilat mund të rrisnin sigurinë

Grafik 20. Rezultatet mbi perceptimin e kontributit të ushtrisë në siguri

Grafik 21. Rezultatet mbi perceptimin e kontributit të shërbimeve sekrete(SHISH) në siguri.

Grafik 22. Rezultatet mbi pritshmëritë e sigurisë për vitin e ardhshëm

Grafik 23. Rezultatet mbi perceptimin për kërcënimet numër një dhe numër dy për sigurinë e Shqipërisë

Grafik 24. Rezultatet mbi perceptimin për kërcënimet numër një dhe numër dy për sigurinë e Ballkanit

Grafik 25. Rezultatet mbi perceptimin e marrëdhënieve midis shteteve ballkanike në krahasim me një vit më parë

Grafik 26. Rezultatet mbi perceptimin për kërcënimet numër një dhe numër dy për sigurinë Ndërkombëtare

Grafik 27. Rezultatet mbi perceptimin e tre vendeve më miqësore me Shqipërinë

Grafik 28. Rezultatet e agreguara për tre vendet më miqësore me Shqipërinë

Grafik 29. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të NATO e BE në sigurinë e Shqipërisë

Grafik 30. Rezultatet mbi pritshmëritë e sigurisë pas anëtarësimit në BE

Grafik 31. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të SHBA e Gjermanisë

Grafik 32. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të Turqisë, Rusisë, Kinës, Iranit e Vendeve Arabe

Grafik 33. Rezultatet mbi pritshmëritë e periudhës së nevojshme për anëtarësim

Grafik 34. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të korrupsionit e krimit të organizuar për pengimin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE

Grafik 35. Rezultatet mbi pritshmëritë e fitimit të luftës ndaj krimit të organizuar

Grafik 36. Rezultatet mbi pritshmëritë e fitimit të luftës ndaj krimit të organizuar e ndarë sipas dy gjinive

Grafik 37. Rezultatet mbi pritshmëritë e periudhës që nevojitet për fitimin e luftës ndaj krimit të organizuar

Grafik 38. Rezultatet mbi pritshmëritë e periudhës që nevojitet për fitimin e luftës ndaj krimit të organizuar e ndarë sipas dy gjinive e grupeve të ndryshme moshore

Grafik 39. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me luftën kundër krimit të organizuar nga shteti

Grafik 40. Rezultatet mbi perceptimin e respektimit të të drejtave të njeriut nga policia

Grafik 41. Rezultatet mbi perceptimin e trajtimit të barabartë nga policia

Grafik 42. Rezultatet mbi perceptimin e punësimit në administratë sipas meritë/aftësive

Grafik 43. Rezultatet mbi perceptimin e punësimit në institucionet e sigurisë sipas meritë/aftësive

Grafik 44. Rezultatet mbi perceptimin për korrupsionin në prokurimet/tenderat e institucioneve të sigurisë

Grafik 45. Rezultatet mbi perceptimin e pavarësisë së institucioneve të sigurisë nga ndikimi politik

Grafik 46. Rezultatet mbi perceptimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë nga ndikimi politik

Grafik 47. Rezultatet mbi perceptimin e forcimit të luftës ndaj korrupsionit dhe kimit të organizuar me anën e krijimit të SPAK

Grafik 48. Rezultatet mbi pritshmërinë lidhur me përmirësimin e efektshmërisë së gjykatave në luftën ndaj korrupsionit pas reformës në drejtësi

Grafik 49. Rezultatet mbi perceptimin e kontrollit të parlamentit mbi institucionet e drejtësisë

Grafik 50. Rezultatet mbi gjykimin nëse kontrolli i parlamentit mbi institucionet e drejtësisë duhet rritur

Grafik 51. Rezultatet mbi besimin në Qeveri, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes

Grafik 52. Rezultatet mbi besimin në SHISH, Zjarrfikësit, Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura

Grafik 53. Rezultatet mbi besimin në policitë private

Grafik 54. Rezultatet mbi besimin në institucionet e drejtësisë

Grafik 55. Rezultatet mbi perceptimin lidhur me korrupsionin në agjencitë e ofrimit të sigurisë

Grafik 56. Rezultatet mbi perceptimin lidhur me korrupsionin në institucionet e drejtësisë

Parathënie

Vështirë se ka një fushë politike në të cilën perceptimet luajnë një rol më të rëndësishëm sesa në fushën e politikës së sigursë. Perceptimi i qytetarëve për kërcënimet e sigursë dhe parashikimi i sigursë si një nga funksionet themelore të shtetit ka një ndikim vendimtar në shoqëritë dhe zhvillimin e tyre. Ato ndikojnë në përparimin ekonomik dhe social, mbështetjen për rishpërndarje të masave, gatishmërinë e qytetarëve për të marrë përsipër përgjegjësi në komunitetin e tyre dhe shumë aspekte të tjera që përcaktojnë vetë bazën e kontratës sociale të çdo shoqërie.

Me rëndësi është se rritja e perceptimeve jo domosdoshmërisht korrespondon me dinamikën e rreziqeve aktuale. Për shembull, aktet selektive të dhunës mund të kenë një ndikim të fortë në perceptimin e sigursë individuale, shumë më të fortë se sa ajo që do të korrespondonte me kërcënimin aktual në jetën e përditshme të një qytetari. Sidoqoftë, është perceptimi në veçanti i cili duhet të merret parasysh kur debatohet për zgjidhje të përshtatshme politike për shkak të efektit të tyre në shoqëri dhe zhvillimit të saj.

Në të njëjtën kohë, politika e sigursë duhet të lejojë një ekuilibër delikat të parashikimit të sigursë (dhe krijimin e një perceptimi të duhur të saj) dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore demokratike. Edhe masat bazike të ligjshme të sigursë kufizojnë lirinë e qytetarëve në një farë mase. Megjithatë, nëse keqpërdoren, ato madje mund të bëhen një mjet i sigurt për strukturat e pushtetit që të pengojnë proceset demokratike.

Gjetja e këtij ekuilibri midis plotësimit të nevojave të sigursë së shoqërive nga njëra anë dhe garantimit të të drejtave themelore nga ana tjetër, kërkon një diskutim të gjerë duke përfshirë vendimmarrësit politikë dhe aktorët shoqërorë.

Ky diskutim mbi politikën e sigursë duhet të jetë një ushtrim i vazhdueshëm. Perceptimet ndryshojnë së bashku me zhvillimin dinamik të rreziqeve dhe aktorëve. Çështjet e sigursë shtrihen në nivele të ndryshme, - nga niveli lokal në atë global. Ato ndryshojnë nën një sërë kushtesh dhe veprimesh komplekse.

Problemet variojnë nga krimi i organizuar dhe efektet e korrupsionit në kontekstin kombëtar deri tek terrorizmi ndërkombëtar dhe një mjedis global gjithnjë e më armiqësor. Të gjitha këto çështje përshihen në perceptimin e qytetarëve të cilat janë paraqitur në këtë Barometër Shqiptar të Sigursë. Të dhënat dhe informacionet janë mbledhur dhe analizuar për të shërbyer si një burim për dialogun e politikave të sigursë dhe për të lehtësuar zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse me përfshirjen e një game më të gjerë të aktorëve shoqërorë. Shoqëria civile duhet të ketë një rol të fuqishëm në këtë dialog duke këmbëngulur në një shqyrtim të kujdesshëm të nevojave të sigursë dhe lirive themelore.

Për Zyrën e Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) Tiranë, ky botim është pjesë e synimit tonë më të madh për të mbështetur paqen dhe zhvillimin shoqëror në të gjithë botën, në këtë rajon dhe në Shqipëri. Ne e shohim të rëndësishme këtë mbështetje veçanërisht për shkak të lidhjes midis sigurisë dhe zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Sikurse edhe Willy Brandt, ish-kancelari gjerman dhe laureat i çmimit Nobel për Paqen, ka thënë: "Politika e zhvillimit është politika e paqes e shekullit të 21-të", duke treguar rëndësinë e efektit të ndërsjellët të dy fushave të politikave në të cilat mbështetet puna jonë.

I jemi mirënjohës Arjan Dyrmishi dhe ekipit të tij në Qendrën e Studimit të Demokracisë dhe Qeverisjes për punën e tyre të rëndësishme dhe të jashtëzakonshme. Shpresojmë që informacioni gjithëpërfshirës që jep Barometri do të zhvillojë një debat politikash të mëtijshme për një politikë të qëndrueshme të sigurisë që lejon një zhvillim më të fuqishëm shoqëror në Shqipëri.

Stine Klapper

Shefi i Zyrës FES Tiranë

Hyrje

Siguria është një prej aspekteve më përcaktues të çdo shoqërie të së drejtës dhe një funksion themelor i shtetit. Strategjia e Sigurisë e BE-së e ka përcaktuar sigurinë si një aspekt thelbësor dhe si një kusht paraprak i zhvillimit ekonomik dhe social.¹

Përgjatë viteve të fundit siguria ka dalë sërish në pah si problem i rëndësishëm më të madhe në shumë fusha dhe nivele.

Në nivelin individual dhe komunitar perceptimet dhe vendimmarrja e përditshme lidhur me aktivitete familjare apo çështje të punësimit, formësohen dhe influencohen edhe nga një shumëllojshmëri shqetësimesh lidhur me sigurinë.

Në nivelin kombëtar, shqetësimet lidhur me krimin e organizuar, korrupsionin, radikalizmin dhe terrorizmin, kanë influencuar vazhdimisht politikën, vendimmarrjen dhe veprimet qeveritare. Dështimet e vazhdueshme në mposhtjen me efektivitet të konglomeratit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, sollën ndërmarrjen dhe zbatimin e një reforme gjithëpërfshirëse të drejtësisë. Lindja e organizatës terroriste ISIS, të cilës iu bashkuan 144 qytetarë shqiptarë, shpuri në ndërmarrjen e masave dhe politikave qeveritare me qëllim adresimin e këtij problemi. Pas shpërbërjes së ISIS, shqetësime të sigurisë lidhen me luftëtarët e kthyer apo në kthim, sa i takon përfshirjes potenciale të tyre në aktivitete terroriste apo radikalizuese.

Në nivel rajonal, procesi i vështirë dhe i ngadaltë i integritetit në NATO dhe BE, i përcaktuar si themeli i sigurisë së rajonit, demokratizimi i ngadaltë dhe zhvillimi i dobët ekonomik, kanë penguar formësimin e një komuniteti sigurie ndër vendet e Ballkanit Perëndimor. Mosmarrëveshjet e vazhdueshme dhe çështjet e pazgjidhura kombëtare, kanë ngadalësuar proceset e paqësimit dhe kontribuojnë në nivelin e ulët të mirëbesimit midis qytetarëve të këtyre vendeve, element ky që sjell shqetësime sigurie në fushën e marrëdhënieve ndërshtetërore.

Shqetësimet lidhur me sigurinë dhe zhvillimet në nivelin Europian dhe më gjerë, kanë rezonuar edhe në nivel rajonal dhe kombëtar. Efektet dhe kundërpërgjigjet lidhur me sulmet terroriste në kryeqytetet Europiane, krizat në marrëdhëniet transatlantike dhe pasiguritë lidhur me fuqitë në rritje si Kina dhe Rusia, kanë kontribuar në mënyrat se si siguria kuptohet, perceptohet dhe se si veprohet për ta realizuar atë.

Në mënyrë që të mund të arrihen rezultate në përballjen me këto sfida, qeverive dhe institucioneve të sigurisë, ju jepen resurse të konsiderueshme financiare dhe njerëzore, si dhe kompetenca të zgjeruara.

¹ European Commission. "A Secure Europe in a Better World European Security Strategy". Brussels, 8 December 2003. <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15895-2003-INIT/en/pdf>

Megjithëse këto masa janë një parakusht i nevojshëm për përmbushjen e misionëve të tyre, alokimi i këtyre resurseve financiare dhe kompetencave, i ekspozojnë institucionet e sigurisë ndaj kërcënimeve të ndryshme si korrupsioni dhe abuzimi i të drejtave themelore, që në vetvete gjërryejnë themelet e sigurisë dhe themelet e sistemit demokratik.

Këto sfida kërkojnë një përfshirje konstante dhe të mirinformuar të qytetarëve dhe aktorëve shoqërorë, në mënyrë që të garantojmë që siguria dhe drejtësia të formësohet duke aderuar tek parimet demokratike të sipërpërmendura.

Megjithatë, pavarësisht peshës që siguria ka, si fushë e veçantë politikash, dhe rëndësinë e opinionit publik lidhur me formulimin e politikave dhe dhënien e sigurisë, në Shqipëri nuk ka patur matje sistematike të perceptimeve të popullsisë rreth këtyre aspekteve.

Kjo e ka bërë të vështirë për aktorët shoqërorë dhe publikun e gjerë që të matin masën në të cilën reflektohen nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve në formulimin e politikave të sigurisë në Shqipëri, po aq sa dhe mbi efektivitetin dhe mjaftueshmërinë e këtyre politikave dhe masave në zbatimin dhe arritjen e qëllimeve, si dhe rezultateve të parashikuara.

Në këtë kontekst, Barometri i Sigurisë Shqipëri (BSSH), synon të kontribuojë në mbushjen e hendekut ndërmjet politikë-bërjes dhe dhënies së sigurisë, si dhe shqetësimet dhe pritshmëritë e qytetarëve nëpërmjet matjes së qëndrimeve dhe perceptimeve të publikut.

BSSH-ja është një kontribut i shoqërisë civile ndaj përpjekjeve të përgjithshme për të përmirësuar sistemet e qeverisjes demokratike në Shqipëri. BSSH do të kryhet në mënyrë periodike dhe do të fokusohet në një gamë të gjerë të problemeve dhe shqetësimeve të sigurisë, duke synuar që në një afat më të gjatë të kontribuojë në përmirësimin e dialogut lidhur me politikën e sigurisë.

Barometri synon të kapë qëndrimet dhe perceptimet e opinionit publik lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë, performancën e institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë, rëndësinë dhe efektivitetin e politikave, masave dhe veprimeve të lidhura me sigurinë.

Duke informuar opinionin publik, politikë-bërësit, mediat, OJF-të, dhe publikun e gjerë mbi këto çështje, BSSH do të kontribuojë drejt përmirësimit të debatit lidhur me politikën dhe çështjet e sigurisë në Shqipëri, si dhe përfshirjen më të gjerë të palëve të interesuara shoqërore në këtë debat.

Bazuar në kontekstin e mësipërm, edicioni i parë i BSSH është udhëhequr nga pyetjet e mëposhtme kërkimore:

- 1) Çfarë perceptojnë qytetarët si kërcënimin më të madh të sigurisë në nivele të ndryshme?
- 2) Sa të kënaqur janë ata nga performanca e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në adresimin e kërcënimeve dhe kërcënimeve të sigurisë?

- 3) Në çfarë mase janë plotësuar pritshmëritë e qytetarëve nga ana e masave dhe politikave të sigurisë?
- 4) Cilat janë politikat dhe qasjet që qytetarët mendojnë që do të përmirësonin sigurinë?
- 5) Cili është perceptimi i qytetarëve lidhur me integritetin e institucioneve të sigurisë?
- 6) Sa mendojnë qytetarët se institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë janë të korruptuara, dhe sa i besojnë ata ato?
- 7) Cilat janë perceptimet lidhur me NATO-n dhe BE-në për sa i përket sigurisë së Shqipërisë?
- 8) Cilat janë perceptimet e qytetarëve lidhur me ndikimin ndaj sigurisë së Shqipërisë nga ana e vendeve miqësore dhe ndaj vendeve të cilat janë duke u përpjekur për të rritur ndikimin e tyre në rajonin e Ballkanit?
- 9) Sa e mbështesin qytetarët krijimin e institucioneve të reja për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe cilat janë pritshmëritë e tyre për to?
- 10) Çfarë mendojnë qytetarët lidhur me kontrollin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të sigurisë?
- 11) Çfarë mendojnë qytetarët lidhur me perspektivën e anëtarësimit në BE dhe se si Shqipëria po performon në arritjen e kushteve të BE, specifikisht në lidhje me krijimin e një administrate publike profesionale dhe të pavarur dhe në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Përveç qëllimit për të forcuar ndërlidhjen ndërmjet qëndrimeve dhe shqetësimeve të qytetarëve dhe politikave të sigurisë dhe realizimit të tyre, pyetjet kërkimore dhe të dhënat e mbledhura me anën e BSSH, kanë për qëllim edhe stimulimin e hulumtimit të mëtejshme dhe advokuar për përmirësimin e politikave në fushën e sigurisë.

Metodologjia

PYETËSORI

Pyetëtori i përdorur për këtë anketë përbëhet nga 80 pyetje me alternativa, nga të cilat 8 ishin demografike/gjeografike, dhe 1 është administrative.

Disa pyetje janë të ndërlidhura me njëra tjetrën në sens rendor në rangun e 2 ose 3 pyetjeve (10 dhe 11; 12 dhe 13; 14 dhe 15; 16 dhe 17; dhe 19, 20 dhe 21). Në marrjen e përgjigjeve ndaj këtyre pyetjeve, të anketuarit duhet të përjashtonin alternativën e parë të dhënë në pyetjen e mëparshme (si dhe alternativën e parë dhe të dytë në pyetjet me 3 sekuenca). Pyetjet sekuenciale janë zgjedhur për ato çështje për të cilat nevojitet mbledhja e të dhënave suplementare për një analizë më në thellësi.

Për shembull, në pyetjen 19, 20, 21, të anketuarve iu kërkua që të jepnin vendin më shumë miqësor ndaj Shqipërisë dhe më pas vendin e dytë dhe të tretë më miqësor. Duke kombinuar të dhënat e mbledhura me anën e këtyre pyetjeve, ne arritëm që të observonim se cilat ishin alternativat më të shpeshta të cilat thuheshin nga të anketuarit (Pyetëtori i plotë në Aneksin 1).

KAMPIONI

Për këtë anketë kemi përdorur një kampion rastësor të shtresëzuar prej 1115 personash në moshë madhore. Në shtresën e parë, observimet ishin të ndara në mënyrë proporcionale ndërmjet 61 bashkive të Shqipërisë, bazuar në popullsinë në moshë madhore të këtyre zonave. Në shtresën e dytë, observimet janë shpërndarë në mënyrë proporcionale midis zonave urbane, periferike dhe rurale, brenda çdo bashkie (Aneksi 2). Më pas kemi zhvilluar kuota proporcionale lidhur me moshën dhe gjininë e secilës nënshtresë. Në fund, pikat gjeografike janë paracaktuar në mënyrë rastësore në hartën e Shqipërisë, sipas skemës së mësipërme të kampionimit (Figura 1).

Qëllimi i kësaj skeme të shtresëzuar të kampionimit ishte arritja e një përfaqësimi sa më të saktë gjeografik dhe demografik të popullsisë në moshë madhore të vendit, duke mbajtur një marzh gabimi më të vogël sesa $\pm 2.9\%$ për të tërë kampionin dhe jo më shumë sesa $\pm 4.1\%$ për nën-kampionet.

Ky kampionim i rastësishëm garanton që çdo banor i Shqipërisë ka probabilitet të barabartë për tu zgjedhur për të marrë pjesë në këtë anketë. Me këtë metodë kampionimi, rezultatet e kësaj ankete i reflektojnë sjelljet dhe perceptimet e totalit të popullsisë në moshë madhore të Shqipërisë.

Marzhi i gabimit statistikor për kampionin e plotë është $\pm 2.9\%$

Marzhi i gabimit statistikor për nënkampionin e femrave është $\pm 4\%$

Marzhi i gabimit statistikor për nënkampionin e meshkujve është $\pm 4\%$

Marzhi i gabimit statistikor për nënkampionin e qyteteve është $\pm 3.9\%$

Marzhi i gabimit statistikor për nënkampionin e fshatrave/rrethinave është $\pm 4.1\%$

Marzhi i gabimit statistikor për nënkampionin e arsimit të ulët/mesëm është $\pm 3.4\%$

MBLEDHJA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Kjo anketë është kryer me anën e intervistimit ballë për ballë të personave, sipas skemës së sipërme të kampionimit. Përpara dërgimit në terren, 28 anketuesit janë trajnuar nga skuadra e menaxhimit të projektit në Shtator 2019. Gjatë trajnimit janë kryer anketa të simuluar për të testuar pyetësonin dhe për të vërejtur reagimet e anketuesve ndaj situatave të mundshme gjatë anketimit në kushtet reale.

Puna në terren për mbledhjen e të dhënave filloi më 27 Shtator dhe përfundoi në 7 Tetor 2019. Përgjigjet e të anketuarve janë regjistruar në mënyrë direkte në smartphonet e anketuesve dhe i janë transmetuar në mënyrë direkte serverit qendror me anën e një software të veçantë të prodhuar specifikisht për këtë studim nga ana e specialistit të IT të projektit. Koha dhe vendi i çdo ankete është regjistruar automatikisht me anën e një software gjithashtu të dizenuar specifikisht për këtë projekt. Informacioni është përdorur në mënyrë të përditshme, metodologjisti dhe 13 mbikëqyrësit në terren, me qëllim sigurimin e kryerjes së anketave sipas skemës së paracaktuar të kampionimit dhe udhëzimeve metodologjike. Mbikëqyrësit kanë kryer kontrole të përditshme rastësore cilësie për të garantuar kryerjen e anketave në zonat e paracaktuara për tu mbikëqyrur.

Në fund të punës në terren, është kryer kontrolli i cilësisë së të dhënave të mbledhura në server nga ana e anketuesve. Përpara analizimit të të dhënave, kampioni është rimatur për të përfaqësuar shpërndarjen ekzakte të moshës sipas raporteve të Institutit të Statistikave (INSTAT). Më pas të dhënat janë përpunuar dhe analizuar duke përdorur softwarin STATA 11.

Përveç analizës së të dhënave të gjeneruara nëpërmjet kampionit të përgjithshëm, aty ku është gjykuar si e nevojshme janë analizua dhe të dhënat të prodhuara duke u bazuar në nën-kampionët e gjinisë, arsimit, apo shpërndarjes gjeografike (rurale/urbane).




Figura 1: Shpërndarja gjeografike e kampioneve

GJETJET KRYESORE


- Një pjesë e madhe e qytetarëve ndihen të sigurt në vendbanimin dhe në vendin e punës së tyre. Megjithatë, pasiguria në vendin e punës është më e lartë se në vendbanim.
- Vjedhja, grabitja, konfliktet lidhur me pronën dhe vrasjet, perceptohen si kërcënimet kryesore ndaj sigurisë personale. Megjithatë, vjedhja perceptohet si një kërcënim nga shumica e qytetarëve. Banorët e zonave rurale dhe periferike ndihen më pak të sigurt sesa ata në zonat urbane.
- Kënaqësia e përgjithshme me situatën e sigurisë nga ana e institucioneve në krye të kësaj detyre është kryesisht e lartë. Policia e Shtetit konsiderohet si ofruesi kryesor i sigurisë, por një pjesë e madhe e qytetarëve identifikojnë veten si ruajtësit kryesorë të sigurisë së tyre. Një numër më i madh qytetarësh tregojnë se janë të kënaqur me kontributin e Ushtrisë për sigurinë sesa të shërbimeve të inteligjencës.
- Më shumë se gjysma e qytetarëve kanë pritshmëri që situata e sigurisë të jetë e njëjtë ose më e keqe për 12 muajt e ardhshëm.
- Qytetarët identifikojnë një ndërlidhje midis prezencës së policisë dhe masave të sigurisë, por rritja e numrit të policëve si mënyrë e përmirësimit të sigurisë, nuk mbështetet nga shumica e qytetarëve. Nga ana tjetër, përmirësimi i sigurisë me anën e modernizimit të policisë shihet si një opsion më i preferueshëm nga një shumicë më e madhe e popullsisë. Të dy elementët, rritja e numrit të policëve dhe modernizimi i policisë, favorizohen më shumë nga ana e qytetarëve që jetojnë në zona rurale dhe periferike.
- Korrupsioni, krimi i organizuar dhe papunësia, perceptohen si tre kërcënimet kryesore ndaj sigurisë në Shqipëri. Për rajonin e Ballkanit, perceptimi është që kërcënimet kryesorë të sigurisë është lufta midis shteteve, terrorizmi, krimi i organizuar dhe korrupsioni. Në nivel global, terrorizmi, lufta midis shteteve dhe ngrohja globale perceptohen si tre kërcënimet kryesore të sigurisë.
- Më shumë sesa gjysma e qytetarëve mendojnë se marrëdhëniet midis shteteve të Ballkanit nuk janë përmirësuar gjatë vitit të fundit.
- Qytetarët e Shqipërisë konsiderojnë NATO-n dhe BE-në si kontribuues pozitivë ndaj sigurisë së Shqipërisë dhe mendojnë se siguria e Shqipërisë do të përmirësohet me anëtarësimin në BE. Qytetarët e Shqipërisë mbeten optimistë lidhur me anëtarësimin në BE, pasi më shumë se 90% mendojnë se vendi do të arrijë këtë objektiv brenda 20 vjetëve në rastin më të vonë. Vetëm një përqindje e vogël mendojnë se anëtarësimi s'do të ndodhë asnjëherë.
- SHBA, Gjermania dhe Italia janë identifikuar si tre shtetet më miqësore ndaj Shqipërisë. Megjithatë, qytetarët shqiptarë shfaqen si të painformuar plotësisht lidhur me të ashtuquajturin kërcënim ndaj sigurisë nga ana e ndikimit të vendeve

të treta. Një përqindje e lartë e qytetarëve mendojnë se ndikimi i Rusisë, Kinës, Turqisë, Iranit dhe vendeve Arabe është neutral apo dhe pozitiv, ndaj sigurisë së Shqipërisë.

- Korrupsioni dhe krimi i organizuar shihen si pengesat kryesore ndaj integritetit në BE nga ana e një shumice të madhe prej 86.55% të qytetarëve. Gjysma e qytetarëve mendojnë se lufta kundër krimit të organizuar nuk do të fitohet kurrë. Qytetarët më të rinj janë më skeptikë ndaj arritjeve në luftën kundër krimit të organizuar.
- Një shumicë e madhe e qytetarëve mendojnë se policia nuk i trajton të tërë qytetarët në mënyrë të barabartë dhe se nga të punësuarit në administratën shtetërore dhe institucionet e sigurisë, një pakicë prej tyre janë punësuar në bazë të meritave dhe aftësive të tyre.
- Qytetarët mendojnë se ndikimi politik mbi institucionet e sigurisë është kryesisht i lartë, ku Doganat janë institucioni më i ndikuar nga politika, ndjekur nga Policia e Shtetit, SHISH dhe Ushtria. Institucionet e Drejtësisë, të Prokurorisë dhe Gjykatat, perceptohen si më të ndikuarat nga politika.
- Besimi i qytetarëve tek qeveria, ministrat dhe institucionet e sigurisë është mesatar ndërkohë që perceptimi për përhapjen e korrupsionit është i lartë. Doganat perceptohen si më të korruptuarat dhe më pak të besuarat, ndërkohë që Ushtria perceptohet si më pak e korruptuar dhe gëzon më shumë besim sesa SHISH dhe Policia e Shtetit.
- Institucionet e Drejtësisë, Prokuroria dhe Gjykatat, perceptohen si më të korruptuara dhe kanë një nivel më të ulët besimi sesa institucionet e sigurisë. Megjithatë niveli i besimit tek Prokuroria Speciale dhe Gjykatat Speciale kundër korrupsionit dhe krimit është shumë i lartë, dhe qytetarët mendojnë se lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të fuqizohet pas formimit të plotë të tyre.

INFORMACION DEMOGRAFIK


Nga 1115 të anketuarit 50.13% ishin femra dhe 49% ishin meshkuj. Ndarja moshore është pothuaj e barabartë për të katër grupet si tregohet në grafikun e mëposhtëm.



Grafik 1. Moshat e të Anketuarve


Shumica e popullsisë së anketuar banon në zona urbane, 56.68%, dhe 9.6% në zona periferike. Pothuaj një e treta e të anketuarve jetojnë në zona rurale 33.72%. Përsa i përket etnive, 97.67% të të anketuarve janë deklaruar si Shqiptarë, 1.35% si Grekë, 0.45% si Arumunë, 0.45% si Maqedonas(të Veriut) edhe 0.45% si tjetër.

Rreth 23.8% e të anketuarve kanë një edukim universitar, 2.24% kanë edukim pasuniversitar ndërkohë që përqindja më e madhe prej 47.71% kanë përfunduar arsim 12 vjeçar të mesëm dhe 26.46% kanë përfunduar edukimin e detyrueshëm.



Grafik 2. Niveli i arsimit i të anketuarve

Përsa i përket profesionit, 24.22% e të anketuarve deklarojnë se janë të vetëpunësuar dhe po aq se janë pensionistë. 17.31% janë deklaruar si të papunë (Niveli i papunësisë në Shqipëri është raportuar si 11.4% nga INSTAT në Shtator 2019) ²




Grafik 3. Profesioni i të anketuarve

² <http://www.instat.gov.al/media/6551/lfs-q3-2019.pdf>

PERCEPTIMET RRETH KËRCËNIMEVE VETIAKE DHE KOMUNITARE TË SIGURISË


Për të mësuar për sigurinë personale dhe atë të komunitetit, qytetarëve iu është kërkuar që të tregojnë cili është perceptimi i tyre për sigurinë në punë dhe në vendbanimin e tyre, me supozimin që do të ketë ndryshime midis të dyjave.

Megjithëse shumica më e madhe e të anketuarve deklarojnë se ndihen të sigurt (67,35%), rreth 9% e tyre deklarojnë se ndihen “shumë të pasigurtë” ose “të pasigurtë”, dhe 24.13% ndihen “disi të sigurtë” në vendbanim.



Grafik 4. Rezultate lidhur me perceptimin e sigurisë në vendbanim rural/suburban

Tendenca të ngjashme shihen edhe lidhur me vendin e punës, megjithëse përse i përket shifrave ka disa ndryshime pasi 37.85% deklarojnë që nuk punojnë.




Grafik 5. Rezultate lidhur me perceptimin e sigurisë në vendin e punës rural/suburban

Përgjithësisht, pasiguria duket më e lartë midis qytetarëve meshkuj, ndërsa pasiguria në punë është më e lartë sesa në vendbanim për të dyja gjinitë.

4.65% e të anketuarave femra shprehen se nuk ndihen të sigurt në vendin e punës krahasuar me 3.4% në vendbanim.

Në mënyrë të ngjashme, një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve meshkuj (8.09%), shprehen se nuk ndihen të sigurtë në vendin e punës, krahasuar me 2.7% në vendbanim.

Perceptimet mbi sigurinë në vendin e punës dhe banimit për femrat dhe meshkujt




Grafik 6. Rezultate lidhur me perceptimin e sigurisë në vendin e punës/banimit për të dy gjinitë

Vjedhja, grabitja, konfliktet mbi territorin, perceptohen si kërcënimet numër një të sigurisë personale.

Megjithatë, vjedhja perceptohet si kërcënimi numër një nga një shumicë më e madhe e të anketuarve, 39.55%, ndërkohë që grabitja vjen e dyta me 7.71%, konfliktet mbi pronën 7.98%, dhe vrasja me 7%.

Krimi i organizuar, vandalizmi dhe dhuna në familje, perceptohen si kërcënime kryesore nga një përqindje më e vogël e të anketuarve.

Kërcënimet Nr. 1 dhe 2 për sigurinë personale



Grafik 7. Rezultatet mbi perceptimin e kërcënimit numër një dhe numër dy për sigurinë personale

Siguria perceptohet si më e ulët në zonat rurale dhe suburbane, me vetëm 22.41% të të anketuarve që deklarojnë se nuk perceptojnë të ketë asnjë kërcënim, ndërkohë që vjedhja perceptohet si kërcënim numër një i sigurisë për 45.4% e popullsisë rurale dhe suburbane, 8.5% më shumë sesa në zonat urbane.


Grabitja perceptohet gjithashtu si një kërcënim më i lartë në zonat rurale dhe suburbane: 18.51% përkundrejt 8.34% në zonat urbane. Tendenca të ngjashme gjenden në këtë kategori si kërcënim i dytë më i rëndësishëm.

Pothuajse dyfishi i të anketuarve në zonat rurale dhe suburbane shohin konfliktet për pronën si kërcënim numër një në krahasim me banorët urbanë: 12.07% në zonat rurale e suburbane përkundrejt 6.13% në zonat urbane.

Këto trende përmbysen në lidhje me krimin e organizuar i cili duket se është një kërcënim më i madh ndaj sigurisë në zonat urbane: 5.48% përkundrejt 2.87% në zonat rurale e suburbane.

Perceptimi lidhur me dhunën në familje është më i lartë si kërcënim i dytë më i rëndësishëm i sigurisë për të dyja kategoritë, banorët urbanë dhe për ata në zonat rurale e suburbanë.

Kërcënimet për sigurinë Nr. 1 dhe Nr. 2 në zonat urbane dhe rurale/suburbane



■ Kërcënimi Nr. 1 - Urbane ■ Kërcënimi Nr. 2 - Urbane ■ Kërcënimi Nr. 1 - Rurale/Suburbane ■ Kërcënimi Nr. 2 - Rurale/Suburbane


Grafik 8. Rezultatet mbi perceptimin e kërcënimit numër një dhe numër dy i ndarë sipas të dy llojeve të vendbanimeve

Megjithëse të ty gjinitë perceptojnë vjedhjen si kërcënimin numër një ndaj sigurisë, numri i femrave të cilat kanë këtë perceptim është pak më i lartë.

Dhuna në familje identifikohet si një kërcënim ndaj sigurisë nga 0.54% e burrave, por rreth 5 herë më i lartë për femrat, me 2.68%.

4.47% e femrave perceptojnë dhunën në familje si kërcënimin numër dy më të rëndësishëm përkundrejt 2.34% e meshkujve.

Kërcënimet për sigurinë Nr. 1 dhe Nr. 2 për femrat dhe meshkujt




Grafik 9. Rezultatet mbi perceptimin e kërcënimit numër një dhe numër dy ndarë sipas të dy gjinive

KËNAQËSIA ME SIGURINË DHE QËNDRIMET LIDHUR ME QASJET PËR PËRMIRËSIMIN E SIGURISË

Kryesisht, qytetarët të cilët janë të kënaqur me situatën e sigurisë, janë më të shumtë sesa ata që nuk janë të kënaqur.

35.54% e qytetarëve të anketuar treguan që janë shumë të kënaqur me situatën e sigurisë në vendbanimet e tyre, ndërkohë që vetëm 8.07% treguan që nuk janë aspak të kënaqur.

Megjithatë, pjesa më e madhe e popullsisë ka perceptime mesatare lidhur me situatën e sigurisë, me 44.57% që tregojnë se janë disi të kënaqur dhe 11.84% që deklarojnë që janë pak të kënaqur.




Grafik 10. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me situatën e sigurisë

Dy të tretat e të anketuarve kanë dhënë kryesisht pikëpamje pozitive përsa i përket bashkëpunimit të policisë më qeverinë vendore lidhur me garantimin e sigurisë (62.78%). 19.28% e të anketuarve janë deklaruar si “shumë të kënaqur” dhe 43.5% janë deklaruar si “disi të kënaqur” me bashkëpunimin në fjalë.

Kjo tendencë e përgjithshme pozitive mund të shpjegohet me përpjekjet e intensifikuara ndër vitet e fundit për të fuqizuar bashkëpunimin në nivel vendor nën strukturën e qasjes së policimit me komunitetin.

Megjithatë, një e treta e të anketuarve, 33.82% mendojnë se ky bashkëpunim nuk është i kënaqshëm.

Sa i/e kënaqur jeni me bashkëpunimin mes qeverisë lokale dhe policisë për garantimin e sigurtisë publike?




Grafik 11. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me bashkëpunimin midis pushtetit vendor-policisë për sigurinë

Për të kuptuar shkallën e kontributit në dhënien e sigurtisë së perceptuar, qytetarët u pyetën për institucionet e ndryshme të cilat janë të përfshira në dhënien e sigurtisë.

Përsa i përket dhënies së sigurtisë në mënyrë të përditshme, Policia e Shtetit u identifikua si ofruesi më i rëndësishëm i sigurtisë, sipas 59.46% të të anketuarve. Një përqindje e madhe e të anketuarve 28.88% identifikuan veten si kontributorin kryesor për sigurinë e tyre.

Kompanitë private të sigurtisë perceptohen si kontributorët më pak të rëndësishëm, por edhe policia bashkiake shihet si kontributor i vogël, pasi vetëm 4.04% e të anketuarve e perceptojnë se kontribuon në sigurinë e tyre.

Cili nga këto luan rolin më të rëndësishëm për sigurinë tuaj të përditshme?




Grafik 12. Rezultatet mbi subjektin më të rëndësishëm për garantimin e sigurisë

Varësia ndaj policisë për masa të sigurisë është evidente dhe kur qytetarët pyeten për prezencën e policisë në nivel komunitar.

Vetëm 47.98% e të anketuarve mendojnë se policia ka prezencë të mjaftueshme, megjithëse numri i qytetarëve që mendojnë se prezenca është tërësisht e pamjaftueshme është vetëm 17.85%.

A është mjaftueshëm e pranishme policia në lagjen/fshatin tuaj?




Grafik 13. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me prezencën e policisë në lagje/fshat

Megjithatë, ka disa diferenca të vogla në varësi të faktit nëse të anketuarit jetojnë në zona urbane apo rurale/suburbane.

Numri i qytetarëve të cilët jetojnë në zona rurale/suburbane, të cilët mendojnë se prezenca policore është e pamjaftueshme, është më i vogël.

Opinion mbi prezencën e policisë në zonat urbane vs rurale/suburbane




Grafik 14. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me prezencën e policisë në zona rurale/suburbane në krahasim me zonat urbane

Për të mësuar mbi perceptimin e qytetarëve dhe pritshmëritë e tyre përsa i përket ndërlidhjes midis sigurisë dhe prezencës policore, qytetarëve iu bënë dy pyetje: “Sa ndikon prezenca e policisë në terren në siguri?” dhe “Sa mendoni ju se do ta rriste shtimi i numrit të policëve sigurinë?”

Ndërkohë që përsa i përket lidhjes midis prezencës policore dhe sigurisë, të anketuarit vazhdojnë në të njëjtën linjë me përgjigjet e mëparshme, kur kemi të bëjmë me mundësinë e përmirësimit të sigurisë me shtimin e numrit të policëve për territor, përgjigjet ndryshojnë.

47.17% e të anketuarve mendojnë që prezenca policore kontribuon “shumë” në përmirësimin e sigurisë, por vetëm 40.72% mendojnë që rritja e numrit të policëve do të kontribuonte “shumë” në rritjen e sigurisë. Në mënyrë që ngjashme, 11.66% tregojnë se kjo nuk do të kontribuonte aspak në përmirësimin e sigurisë.




Grafik 15. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të prezencës policisë me nivelin e sigurisë

Nga ana tjetër, modernizimi i policisë si një faktor për përmirësimin e mëtejshëm të sigurisë, shihet nga ana e qytetarëve si një opsion më i pëlqyer, sesa shtimi i numrit të policëve. 63.68% e të anketuarve mendojnë se modernizimi do të rriste shumë sigurinë, me 24.13% të tjerë të cilët mendojnë se ky opsion do ta rriste disi sigurinë.

Vetëm 11.56% mendojnë se kjo zgjedhje do të kontribuonte pak ose aspak ndaj përmirësimit të sigurisë.


Sa mendoni se do ta rriste sigurinë modernizimi i mëtejshëm i policisë?



Grafik 16. Rezultatet mbi pritshmëritë e përmirësimit të policisë nga modernizimi

Të anketuarit në zonat rurale e suburbane që mendojnë se përmirësimi i dhënies së sigurisë me anën e të dy mënyrave, domethënë më shumë policë në terren dhe modernizim i mëtejshëm, është më i lartë. Kjo thekson deficitet në masat e sigurisë të cilat vërehen përgjithësisht në këto zona në krahasim me ato urbane.


Rritja e prezencës së policisë dhe përmirësimi i sigurisë në zonat urbane vs suburbane/rurale



Grafik 17. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të prezencës së policisë me nivelin e sigurisë, ndarë sipas dy llojeve të vendbanimeve.

67.82% e qytetarëve që banojnë në zona rurale/suburbane janë në favor të rritjes së sigurisë me anën e modernizimit të policisë ndërkohë që ky option suportohet nga 62.8% e banorëve në zonat urbane.

Modernizimi i policisë dhe përmirësimi i sigurisë në zonat urbane vs suburbane/rurale




Grafik 18. Rezultatet mbi pritshmëritë e përmirësimit të policisë nga modernizimi i ndarë sipas dy llojeve të vendbanimeve

Të pyetur lidhur me opsionin për përmirësimin e sigurisë ndërmjet organizimit të komunitetit, shtimin e policëve të pranishëm në terren apo fuqizimit të ushtrisë, opsioni i parë është më i preferuar.

58.74% e të anketuarve favorizojnë përmirësimin e organizimit të komunitetit, element i cili do të rriste perceptimin e sigurisë, ndërkohë që 19.73% favorizojnë shtimin e policëve në terren, dhe 18.21% favorizojnë fuqizimin e ushtrisë.


Çfarë do t'ju bënte të ndiheshit më i sigurt?



Grafik 19. Rezultatet mbi perceptimin e masave të cilat mund të rrisnin sigurinë

Qytetarëve iu kërkuar që të shprehnin nivelin e tyre të kënaqësisë me kontributin e ushtrisë në dhënien e sigurisë.

Vetëm 28.79% e të anketuarve shprehen se janë shumë të kënaqur me kontributin e ushtrisë shqiptare ndaj sigurisë së Shqipërisë, një shumë e barabartë me agregatin e atyre që u shprehën se janë pak ose aspak të kënaqur (28.43%). Pjesa më e madhe, 40.36% u përgjigjën se janë “disi të kënaqur”.




Grafik 20. Rezultatet mbi perceptimin e kontributit të ushtrisë në siguri.

Duke qenë se shërbimet e inteligjencës luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien e sigurisë, specifikisht në trajtimin e kërcënimeve të reja dhe të sofistikuara, janë kryer pyetje edhe për këto institucione.

Përgjigjet tregojnë se, në krahasim me policinë dhe ushtrinë, niveli i kënaqësisë me punën e shërbimeve të inteligjencës është shumë më i ulët sesa ai për policinë dhe ushtrinë. Vetëm 16.41% shprehen se janë të kënaqur përkundrejt 28.79% që kanë të njëjtin qëndrim për forcat e armatosura.

Një numër relativisht i lartë qytetarësh, 12.91% u përgjigjën se “nuk e dinin”, element ky që tregon informacionin e pamjaftueshëm i cili i jepet publikut lidhur me shërbimet e inteligjencës në kontekstin e sotshëm të sigurisë.

Sa kontribuojnë shërbimet sekrete Shqiptare në sigurinë e vendit?




Grafik 21. Rezultatet mbi perceptimin e kontributit të shërbimeve sekrete(SHISH) në siguri.

Qytetarëve iu kërkua të jepnin opinionin e tyre përsa i përket pritshmërive të tyre lidhur me sigurinë për vitin e ardhshëm.

Vetëm 45.65% e të anketuarve kanë një pikëpamje pozitive dhe mendojnë që siguria do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm.

44.3% mendojnë se siguria do të rrijë e njëjtë, ndërsa 8.25% mendojnë se siguria do të përkeqësohet.

Si do të jetë situata e përgjithshme e sigurisë në 12 muajt e ardhshëm?



Grafik 22. Rezultatet mbi pritshmëritë e sigurisë për vitin e ardhshëm.

PERCEPTIME RRETH SIGURISË KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Përveç marrjes së perceptimeve rreth sigurisë në nivel individual dhe komunitar, qytetarët u pyetën rreth perceptimeve për kërcënimet ndaj sigurisë në nivel kombëtar, rajonal dhe botëror. Në mënyrë që të merrnim një pikëpamje më të thellë rreth këtyre perceptimeve, qytetarët u pyetën gjatë dy pyetjeve të ndryshme që të identifikonin kërcënimin numër një dhe kërcënimin numër dy të sigurisë në këto tre nivele.

Qytetarët u pyetën në dy pyetje të ndara që të identifikonin kërcënimin e parë më të madh dhe kërcënimin e dytë më të madh ndaj sigurisë së Shqipërisë.

Përsa i përket kërcënimeve të sigurisë ndaj Shqipërisë, të anketuarit identifikuan korrupsionin, krimin e organizuar dhe papunësinë³, si tre kërcënimet më të mëdha.

36.95% mendojnë se korrupsioni është kërcënimi numër një më i madh, ndërsa 27.09% e identifikuan atë si kërcënimin e dytë më të rëndësishëm.

Nga ana tjetër, 18.74% e qytetarëve identifikojnë krimin e organizuar si kërcënimin e parë më të rëndësishëm, por në ndryshim nga korrupsioni, ata që e identifikojnë si kërcënimin e dytë më të madh janë rreth 24.04%.


Luftërat me vendet fqinje nuk janë përjashtuar nga anketa dhe dalin si kërcënimi numër një për 7.62% të të anketuarve dhe si kërcënimi numër dy nga një numër pak më i madh prej 8.07%.

Terrorizmi perceptohet si kërcënimi numër një prej 10.67%, ndërsa 12.2% e perceptojnë si kërcënimin numër dy.

Ekstremizmi i dhunshëm perceptohet si kërcënimi numër një nga 3.23% të të anketuarve dhe nga 3.5% si kërcënimi numër dy.

³Në mënyrë që të mos ngatërrohej papunësia si një problem individual anketuesit u siguruan që të anketuarit të përgjigjeshin rreth papunësisë duke e marrë në konsideratë si një problem të gjerë socio-ekonomik.

Kërcënimet Nr. 1 dhe Nr. 2 për sigurinë e Shqipërisë



Grafik 23. Rezultatet mbi perceptimin për kërcënimet numër një dhe numër dy për sigurinë e Shqipërisë


Lidhur me kërcënimet ndaj sigurisë në rajonin e Ballkanit, ka një ndarje më të shpërndarë për shtatë kërcënimet e sigurisë të identifikuar, megjithatë lufta ndërmjet shteteve, terrorizmi, krimi i organizuar dhe korrupsioni, identifikohen si katër më të rëndësishmit, dhe si kërcënimi numër një dhe si numri dy.

Kërcënimi nga lufta mes shteteve kryeson si kërcënimi numër një, me 28.52% e qytetarëve mendojnë në këtë mënyrë, ndërkohë që 20.27% e shohin këtë kërcënim si të dytin nga rëndësia.

Terrorizmi vjen direkt më pas, po ashtu si kërcënimi numër një (24,48%) dhe numër dy (18.57%), por nëse e bashkojmë me ekstremizmin e dhunshëm, duke marrë parasysh se janë ngushtësisht të lidhura, ky element do të dilte si kërcënimi kryesor.

Në ndryshim nga perceptimi mbi imigracionin si kërcënim për sigurinë kombëtare, për rajonin imigracioni perceptohet si kërcënim nga një numër më i lartë i qytetarëve: 5.29% e vlerësojnë si kërcënimi numër një, ndërsa një numër më i madh (7.53%) e vlerësojnë si kërcënimi numër dy për rajonin

Kërcënimet Nr. 1 dhe Nr. 2 për sigurinë në Ballkan




Grafik 24. Rezultatet mbi perceptimin për kërcënimet numër një dhe numër dy për sigurinë e Ballkanit

Qytetarëve iu kërkua të jepnin opinionin e tyre lidhur me sesi e konsideronin sigurinë e rajonit në krahasim me një vit më përpara.

Më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet midis vendeve të Ballkanit janë në stanjacion. 16.95% e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet midis shteteve të Ballkanit nuk janë përmirësuar, ndërsa 34.53% mendojnë se marrëdhëniet janë në të njëjtin nivel si një vit më parë.

Megjithatë, ka një përqindje të konsiderueshme prej 22.24% të cilët mendojnë se shtetet e rajonit kanë marrëdhënie më të mira dhe një pjesë prej 16.50% nuk janë të sigurt dhe mendojnë se marrëdhëniet mund të jenë përmirësuar.

A janë marrëdhëniet mes shteteve ballkanike më mirë se para 1 viti?




Grafik 25. Rezultatet mbi perceptimin e marrëdhënieve midis shteteve ballkanike në krahasim me një vit më parë

Lidhur me sigurinë botërore, terrorizmi, lufta midis shteteve dhe ngrohja globale perceptohen si tre kërcënimet më të mëdha ndaj sigurisë. Migracioni masiv, ekstremizmi i dhunshëm dhe krimi i organizuar vijnë pas tyre, por janë më të shpeshta si kërcënimet numër dy.

Krimi kibernetik është identifikuar si kërcënimi kryesor nga vetëm 5.2%, gjë që tregon se informacioni i qytetarëve shqiptarë rreth këtij kërcënimi në rritje nuk është i përshtatshëm.

Kërcënimet për sigurinë botërore



Grafik 26. Rezultatet mbi perceptimin për kërcënimet numër një dhe numër dy për sigurinë Ndërkombëtare


PERCEPTIME RRETH NDIKIMIT NDAJ SIGURISË NGA AKTORË TË HUAJ

Duke qenë se siguria në nivel ndërkombëtar përcaktohet nga marrëdhëniet e shteteve në sistemin ndërkombëtar të sigurisë, qytetarët u pyetën se cilin shtet ata konsideronin se është më miqësor me Shqipërinë, rolin e NATO-s dhe BE- së ndaj sigurisë së Shqipërisë, po ashtu dhe për ndikimin e vendeve të ndryshme ndaj sigurisë së Shqipërisë.

VENDET MË MIQËSORE

Qytetarët u pyetën në tre pyetje të ndryshme që të identifikonin nëntë opsione të dhëna rreth cilit vend ata identifikonin si vendi i parë, i dytë dhe i tretë më miqësor ndaj Shqipërisë.

SHBA, Gjermania dhe Italia u identifikuan si tre vendet më miqësore në të tre pyetjet.




Grafik 27. Rezultatet mbi perceptimin e tre vendeve më miqësore me Shqipërinë

Është e rëndësishme që të cilësojmë që megjithëse SHBA-ja perceptohet si vendi numër një përse i përket miqësisë ndaj Shqipërisë, Gjermania dhe Italia identifikohen si vendet numër dy dhe tre më miqësore nga një përqindje më e madhe e të anketuarve.

Pra, në total, Gjermania është identifikuar si vendi më miqësor me 81.52%, SHBA me 70.76% dhe Italia me 70.05%. Turqia vjen e katërta e ndjekur nga Franca dhe Maqedonia e Veriut.

Nga ana tjetër, duhet cilësuar që 25.56% e të anketuarve identifikuan “tjetër” si opsionin e tyre, duke nënkuptuar se një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve identifikojnë se ka dhe shtete të tjera të cilat ata konsiderojnë si më të rëndësishme nga opsionet e dhëna.

Rezultatet e agreguara të tre pyetjeve mbi vendin më miqësor me Shqipërinë




Grafik 28. Rezultatet e agreguara për tre vendet më miqësore me Shqipërinë

NDIKIMI I MBI SIGURINË NGA VENDE DHE AKTORË TË TJERË

Qytetarët u pyetën përsa i përket perceptimeve të tyre lidhur me ndikimin ndaj sigurisë së Shqipërisë nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë.

Shumica e qytetarëve të Shqipërisë konsiderojnë NATO-n dhe BE-në si kontribues pozitivë ndaj sigurisë së Shqipërisë, megjithëse përqindja e atyre që mendojnë se NATO luan një rol më të madh është disi më e madhe.




Grafik 29. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të NATO-s dhe BE- së në sigurinë e Shqipërisë

Perceptimi rreth BE si një kontribues pozitiv ndaj sigurisë reflektohet gjithashtu në përgjigjen rreth ndikimit të BE- së ndaj sigurisë së Shqipërisë pas hyrjes së saj në këtë bashkësi shtetesh.

59.1% e qytetarëve mendojnë se situata e sigurisë në Shqipëri do të përmirësohet ndjeshëm pas hyrjes në BE, ndërsa ata që mendojnë të kundërtën janë 2.33%.

Kjo mund të jetë realisht e lidhur me faktin se BE ka vënë si prioritet luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilën shqiptarët i perceptojnë si dy kërcënimet kryesore të sigurisë.

Sa do të përmirësohet situata e sigurisë në Shqipëri pas antarësimit në BE?



Grafik 30. Rezultatet mbi pritshmëritë e sigurisë pas anëtarësimit në BE


Në vazhdimësi me NATO dhe BE, qytetarët u pyetën rreth perceptimit të tyre rreth ndikimit të shteteve të ndryshme në sigurinë e Shqipërisë.

Përveç SHBA dhe Gjermanisë, si fuqitë kryesore perëndimore brenda NATO dhe BE, qytetarët u pyetën gjithashtu për perceptimin e tyre rreth ndikimit të të ashtuquajturve “aktorë të tretë” ose “fuqi të jashtme”, që përfshijnë ato vende të cilat janë duke u përpjekur për të shtrirë ndikimin e tyre në Ballkan në rivalitet ndaj BE-së dhe NATO-s.

Ndikimi i SHBA, po ashtu edhe i Gjermanisë, perceptohen si një element pozitiv ndaj sigurisë së vendit. Megjithatë, ndonëse numri i qytetarëve të cilët mendojnë se ndikimi i SHBA është shumë pozitiv për sigurinë, është më i lartë, totali i shumës së personave që mendojnë se ndikimi i SHBA është pozitiv apo shumë pozitiv është më i vogël sesa i njëjti total i Gjermanisë. 84.3% e të anketuarve mendojnë se SHBA ushtron një ndikim pozitiv ose shumë pozitiv ndërkohë që 88.61% mendojnë njësoj për Gjermaninë.

Duke qenë se SHBA janë konsideruar tradicionalisht si aktori më me influencë për sigurinë e Shqipërisë, kjo përqindje disi më e lartë për ndikimin e Gjermanisë duhet vënë në dukje. Faktorë si procesi i Berlinit dhe roli i Gjermanisë me mbështetjen e saj për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE për Shqipërinë, mund të jenë arsyeja e këtij opinioni publik. Kjo, edhe sepse anketa u krye dy javë përpara Samitit të BE të 17-18 Tetorit 2019 ku pritej të merrej vendimi për çeljen e negociatave me Shqipërinë.

Ndikimi i SHBA dhe Gjermanisë në sigurinë e Shqipërisë



Grafik 31. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të SHBA dhe Gjermanisë

NDIKIMI I “AKTORËVE TË TRETË”

Përgjatë viteve të fundit, ndërkohë që procesi i integritit në BE ka qenë i ngadaltë, ndërkohë që rajoni ka qenë i ekspozuar ndaj kërcënimeve për tu kthyer në një fushë shahu gjeostrategjike për lojtarët e jashtëm, qytetarët u pyetën lidhur mbi perceptimin për ndikimin e “aktorëve të jashtëm”, ose ndryshe “aktorëve të tretë”, në sigurinë e Shqipërisë.

Qytetarëve iu bë e njëjta pyetje; “Si është ndikimi i këtij vendi për sigurinë e vendit tonë?”, për Rusinë, Kinën, Turqinë, Iranin dhe vendet arabe.

Pavarësisht disa variacioneve, pyetjet nxjerrin një nivel kryesisht të ulët të shqetësimit lidhur me sigurinë e Shqipërisë në lidhje me këto vende.

60.81% e qytetarëve mendojnë se ndikimi i Turqisë në sigurinë e Shqipërisë është pozitiv apo shumë pozitiv, ndërsa 30.22% mendojnë se ndikimi është neutral. Vetëm 6.55% mendojnë se ndikimi i Turqisë është negativ ose shumë negativ.


Pikëpamje të ngjashme tregohen dhe për Kinën dhe vendet arabe (të Gjirit), për të cilat rreth 25% e qytetarëve mendojnë se ndikimi i tyre në Shqipëri është pozitiv ose shumë pozitiv. Një numër më i madh mendojnë se ndikimi i tyre është neutral; Kina 56.23% dhe vendet arabe 49.98%. Vetëm rreth 12% mendojnë se ndikimi i Kinës është negativ ose shumë negativ dhe 17.76% mendojnë të njëjtën gjë për vendet arabe. 6.82% nuk mund të identifikojnë se cili është ndikimi i Kinës. Për vendet arabe kjo përqindje është 9.78%.

Perceptimet për Rusinë dhe Iranin janë disi më të nuancuara, por përsëri nuk arrijnë të njëjtat nivele shqetësimi rreth këtyre vendeve saç përshkruhet në diskursin mbi rreziqet ndaj sigurisë që këto vende paraqesin për Shqipërinë. Vetëm 51.84% mendojnë se ndikimi i Rusisë është negativ ose shumë negativ ndërkohë që 33.72% mendojnë se ai është neutral dhe rreth 7.62% mendojnë se ndikimi i tyre është pozitiv. 6.1% nuk mundën të identifikojnë se cila është natyra e ndikimit të Rusisë.

Lidhur me Iranin, numri i atyre që nuk mundet të identifikojnë natyrën e ndikimit të këtij vendi zë përqindjen më të madhe, krahasuar me çdo vend tjetër në këtë kategori prej 14.89%.

30.22% mendojnë se ndikimi i Iranit në sigurinë e Shqipërisë është negativ ose shumë negativ, ndërsa 45.56% mendojnë se ndikimi i këtij vendi është neutral. Pas Rusisë, Irani vjen i dyti në lidhje me perceptimin negativ ose shumë negativ. Megjithatë, 9.06% mendojnë se ndikimi i Iranit është pozitiv.


Ndikimi i vendeve Arabe, Turqisë, Turqisë, Kinës, Rusisë dhe Iranit në sigurinë e Shqipërisë



Grafik 32. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të Turqisë, Rusisë, Kinës, Iranit dhe Vendeve Arabe

INTEGRIMI NË BE DHE PERCEPTIMI RRETH PRIORITETEVE KYÇE

Përsa i përket perspektivave për anëtarësim në BE, më shumë se gjysma e qytetarëve (58.3%) mendojnë se ky hap ka për të ndodhur brenda pesë deri në dhjetë viteve, ndërkohë që 34.44% kanë mendimin që kjo procedurë do të zgjasë 15 deri në 20 vjet.




Grafik 33. Rezultatet mbi pritshmëritë e periudhës së nevojshme për anëtarësim

Qytetarëve iu drejtuan një seri pyetjesh në lidhje me pesë prioritetet kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit: (1) reforma në administratën publike, përf forcimi i profesionalizmit dhe de-politizimi i saj, (2) përf forcimi i pavarësisë, ef i çencës dhe llogaridhënies së institucioneve të drejtësisë, (3) lufta kundër korrupsionit, (4) lufta kundër krimit të organizuar, (5) përf forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, i politikave kundër diskriminimit dhe implementimi i të drejtave të pronës.

Qytetarët janë shumë të vetëdijshëm lidhur me pengesën që i bën procesit të anëtarësimit në BE korrupsioni dhe krimi i organizuar. 86.55% e të anketuarve u përgjigjën që korrupsioni dhe krimi i organizuar janë arsyet kryesore për mungesën e progresit përsa i përket integritimit në BE, dhe një pjesë tjetër prej 9.42% mendojnë se këto elementë kanë ndikim negativ deri në njëfarë mase. Në total kjo përbën 95.97% të të anketuarve në total.


Sa e pengon situata e korrupsionit dhe krimin të organizuar integrimin e Shqipërisë në BE?



Grafik 34. Rezultatet mbi perceptimin e ndikimit të korrupsionit dhe krimin të organizuar për pengimin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE


Megjithatë shumica janë skeptikë ndaj mundësive të fitimit të luftës kundër këtyre fenomeneve. 50.4% e të anketuarve mendojnë se lufta kundër krimin të organizuar nuk do të fitohet kurrë, ndërsa 46.37% mendojnë të kundërtën.

A mendoni se shteti do ta fitojë luftën me krimin e organizuar?



Grafik 35. Rezultatet mbi pritshmëritë e fitimit të luftës ndaj krimin të organizuar


Vlen të përmendet që të anketuarat femra janë edhe më skeptike se meshkujt përsa i përket perspektivës së fitimit të luftës ndaj krimi të organizuar.



Grafik 36. Rezultatet mbi pritshmëritë e fitimit të luftës ndaj krimi të organizuar e ndarë sipas dy gjinive

Kjo ndarje dallohet edhe në afatet kohore që jepen lidhur me arritjen e progresit në këtë çështje. Kur iu kërkohet të përmendin një afat kohor se kur ata mendojnë që lufta ndaj krimi të organizuar do të fitohet, 35.34% përgjigjen se shteti s' do ta fitojë kurrë luftën kundër krimi të organizuar.


24.45% kanë një perspektivë optimiste duke thënë që lufta kundër krimi të organizuar do të fitohet në pesë vite, për një pjesë tjetër prej 18.39 % kjo do të ndodhë për 10 vjet ndërsa 9.4% mendojnë se do të zgjasë 15 vjet. 12.38% mendojnë se kjo luftë do të fitohet në 30 vite.



Grafik 37. Rezultatet mbi pritshmëritë e periudhës që nevojitet për fitimin e luftës ndaj krimi të organizuar


Duke parë përgjigjet bazuar tek grupet moshore dhe gjinore, rezulton që moshë midis 18-49 vjeç dhe meshkujt janë më skeptikë lidhur me mundësinë e fitimit të luftës ndaj krimi të organizuar.

Për sa vite mund ta fitojë shteti luftën me krimin e organizuar?




Grafik 38. Rezultatet mbi pritshmëritë e periudhës që nevojitet për fitimin e luftës ndaj krimit të organizuar e ndarë sipas dy gjinive dhe grupeve të ndryshme moshore

Kjo ndarje e opinionit publik lidhur me krimin e organizuar reflektohet gjithashtu në kënaqësinë lidhur me performancën e institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar. Vetëm 10.31% u shprehën se janë shumë të kënaqur, ndërkohë që 57% e të anketuarve janë pak, ose aspak të pakënaqur me atë çka është bërë për mposhtjen e këtij problemi.



Grafik 39. Rezultatet mbi nivelin e kënaqësisë me luftën kundër krimit të organizuar nga shteti


Një tjetër kriter kyç për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE është përforcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Perceptimi i përgjithshëm i qytetarëve lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut nga ana e policisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre është i dyzuar. Ka një ndarje të barabartë midis atyre që shprehen se policia i respekton plotësisht të drejtat e tyre 15.61% dhe atyre që shprehen se policia nuk i respekton aspak të drejtat e tyre 14.71%.



Grafik 40. Rezultatet mbi perceptimin e respektimit të të drejtave të njeriut nga policia

Megjithatë, kur pyeten lidhur me barazinë e trajtimit të qytetarëve nga Policia e Shtetit, 74.98% e të anketuarve shprehen se qytetarët nuk trajtohen në mënyrë të barabartë. Vetëm 22.06% mendojnë të kundërtën.

A i trajton Policia e Shtetit të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë?




Grafik 41. Rezultatet mbi perceptimin trajtimit të barabartë nga policia

Duke qenë se reforma e administratës publike, përforcimi i profesionalizmit dhe de-politizimi i saj, janë prioriteti kyç për hapjen e negociatave të BE, BSSH bëri pyetje dhe mbi këtë prioritet.

Përsa i përket punësimit bazuar në merita në administratën publike, 77.2% e qytetarëve të anketuar shprehen se vetëm një pakicë e vogël e personave të punësuar në administratën shtetërore janë punësuar bazuar në merita dhe aftësi, ndërsa 12.65% shprehen se askush s'punësohet mbi këto parime.

Sa njerëz punësohen në administratën shtetërore vetëm në bazë të meritës dhe aftësive?




Grafik 42. Rezultatet mbi perceptimin e punësimit në administratë sipas meritë/aftësive

E njëjta tendencë shfaqet edhe kur qytetarëve iu bëhet e njëjta pyetje lidhur me punësimin në institucionet e sigurisë.

Megjithatë ka një përqindje disi më të madhe të atyre që mendojnë se shumica e të punësuarve rekrutohen vetëm në bazë të aftësive të tyre prej 10.85%.


Sa njerëz punësohen në institucionet e sigurisë vetëm në bazë të meritës dhe aftësive?



Grafik 43. Rezultatet mbi perceptimin e punësimit në institucionet e sigurisë sipas meritë/aftësive

Duke qenë se përmirësimet në sistemin e prokurimeve dhe rritja e transparencës dhe konkurrencës në to është një fushë ngushtësisht e lidhur me procesin e integritetit në BE, BSSH përpiloi pyetje specifike lidhur me korrupsionin në prokurimet në institucionet e sigurisë.

Rezultatet tregojnë që 70.31% e qytetarëve mendojnë se korrupsioni është shumë i përhapur në tenderat/prokurimet e institucioneve të sigurisë, me një përqindje shumë të vogël prej 1.79% që mendojnë se ky problem nuk ekziston aspak.




Grafik 44. Rezultatet mbi perceptimin për korrupsionin në prokurimet/tenderat e institucioneve të sigurisë

Përsa i përket de-politizimit, rezultatet janë të dyzuara, por tendenca e përgjithshme tregon se qytetarët mendojnë se ndikimi i politikës në institucionet e sigurisë është kryesisht i lartë.


Doganat perceptohen si institucioni më i ndikuar nga politika me 48.34% e të anketuarve që mendojnë se ata s'janë aspak të pavarur, e ndjekur nga Policia e Shtetit me 39.12%, SHISH me 27.26% dhe Ushtria me 20.09%.

Pavarësia e institucioneve të sigurisë nga ndikimi politik



Grafik 45. Rezultatet mbi perceptimin e pavarësisë së institucioneve të sigurisë nga ndikimi politik

Përsa i përket lidhjes midis institucioneve të drejtësisë dhe ndikimit politik, ka një përqindje më të madhe të qytetarëve që mendojnë se këto institucioneve nuk janë aspak të pavarura. 53.54% e të anketuarve shprehen se gjykatat nuk janë aspak të pavarura dhe 49.51% shprehen njësoj për prokurorinë.




Grafik 46. Rezultatet mbi perceptimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë nga ndikimi politik

Rezultatet e anketës tregojnë një tendencë të përmbysur përsa i përket pritshmërive nga instalimi i institucioneve të reja për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

43.05% e të anketuarve mendojnë se lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të fuqizohet pas formimit të SPAK, ndërkohë ata që janë skeptikë përfaqësojnë vetëm 8.43%.


**Me krijimin e SPAK-ut, sa do të forcohet lufta kundër
korrupsionit dhe krimit të organizuar?**



Grafik 47. Rezultatet mbi perceptimin e forcimit të luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar me anën e krijimit të SPAK

Ngjashmërisht, 41.52% e qytetarëve mendojnë se gjykatat do të jenë shumë më efektive kundër korrupsionit dhe krimit pas reformës në drejtësi ndërkohë që 6.01% mendojnë të kundërtën.

**Sa të efektshme do të jenë gjykatat ndaj korrupsionit e
krimit pas reformës në drejtësi?**




Grafik 48. Rezultatet mbi pritshmërinë lidhur me përmirësimin e efektshmërisë së gjykatave në luftën ndaj korrupsionit pas reformës në drejtësi

Mbikëqyrja demokratike është një tjetër etapë e rëndësishme për progresin e vendit drejt BE-së.

Për të mësuar perceptimin e qytetarëve ndaj këtij dimensionit të sigurisë, pyetjet u kryen lidhur me efektivitetin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj institucioneve të sigurisë. Vetëm 13.54% e qytetarëve mendojnë se mbikëqyrja parlamentare është shumë efektive ndërsa 18.21% mendojnë se kjo nuk është aspak efektive. Një numër më i madh qytetarësh, 35.34% mendojnë se ky element është efektiv deri në një masë të caktuar.


Sa mendoni se është efektiv kontrolli i parlamentit mbi institucionet e sigurisë?



Grafik 49. Rezultatet mbi perceptimin e kontrollit të parlamentit mbi institucionet e sigurisë

Nga ana tjetër, shumica e madhe prej 73.27% e qytetarëve janë të opinionit që mbikëqyrja parlamentare e institucioneve të sigurisë duhet fuqizuar.

Sa mendoni se duhet të forcohet kontrolli i parlamentit mbi institucionet e sigurisë?



Grafik 50. Rezultatet mbi gjykimin nëse kontrolli i parlamentit mbi institucionet e sigurisë duhet rritur

PERCEPTIMI I BESIMIT DHE INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE TË SIGURISË.

Besimi në institucionet e sigurisë

Besimi është një prej themeleve më të rëndësishme mbi të cilat legjitimiteti i institucioneve ndërtohet. Në mënyrë që të kryejnë misionet e tyre këto institucione duhet të besohen dhe mbështeten nga ana e qytetarëve të tyre.

Institucionet e sigurisë kontribuojnë për mbajtjen e rendit dhe stabilitetit social por ato e kryejnë këtë detyrë duke kufizuar lirinë e individëve. Perceptimi rreth shkallës deri ku qytetarët do të besonin institucionet e tyre mund të përdoret si tregues për të dalluar se deri në çfarë pike janë të balancuara masat e sigurisë me kufizimin e lirisë.


Qytetarëve iu është kërkuar të shprehnin opinionin e tyre lidhur me sa besim ata kishin në përmirësimin e sigurisë nga Qeveria, nga Ministria e Mbrojtjes (MB) dhe nga Ministria e Brendshme (MB).

Kryesisht besimi i qytetarëve është i moderuar duke mos patur një diferencë të madhe midis të trejave. MM është pak më shumë e besuar, me 27.62% të qytetarëve që shprehin se kanë shumë besim, dhe 31.21% që shprehin se kanë besim deri në një masë.

21.35% kanë shumë besim tek Qeveria dhe pothuaj po aq nuk kanë fare besim, 21.61%.

MB besohet shumë prej 21.26% e qytetarëve, dhe 24.13% nuk beojnë aspak tek ky institucion.

Besimi në qeveri dhe në ministritë e sigurisë




Grafik 51. Rezultatet mbi besimin në Qeveri, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes

Midis institucioneve të ndryshme, të cilave iu janë ngarkuan detyra të ndryshme në dhënien e sigurisë, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri perceptohet si institucioni më i besuar. 36.59% e qytetarëve kanë shumë besim tek Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri, ndjekur nga Ushtria me 33%, Policia e Shtetit me 29.06%, dhe SHISH me 14.26%.

Megjithatë, ashtu si dhe me pyetjet e tjera ku përmendej SHISH, një përqindje e konsiderueshme prej 10.49% kanë thënë se nuk e dinë, duke treguar për nivelin e kufizuar të informacionit rreth këtij institucioni.


Besimi në agjencitë dhe institucionet qeveritare mbi ofrimin e sigurisë



Grafik 52. Rezultatet mbi besimin në SHISH, Zjarrfikësit, Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura


Duke qenë se kompanitë private të sigurisë janë shfaqur gjithashtu si një ofrues i rëndësishëm i sigurisë publike, por nga ana tjetër reputacioni i tyre është njollosur vitet e fundit nga shumë dështime, qytetarët u pyetën për opinionin e tyre rreth këtyre kompanive si aktor në siguri.

Të anketuarit treguan një nivel më të ulët besimi ndaj policive private në krahasim me institucionet e sigurisë publike. Vetëm 12.38% thanë se i besojnë shumë policive private, ndërsa 29.15% shprehen që nuk i besojnë aspak atyre.



Grafik 53. Rezultatet mbi besimin në policitë private

Megjithatë, një nivel më i ulët besimi shfaqet ndaj institucioneve të drejtësisë. 51.93% e qytetarëve tregojnë se nuk i besojnë aspak Gjykatat, ndërsa 50.04% shprehën të njëjtën gjë për Prokurorinë. Vetëm 6.28% shprehen se kanë shumë besim tek Gjykatat, dhe 7.09% për Prokurorinë.




Grafik 54. Rezultatet mbi besimin në institucionet e drejtësisë

KORRUPSIONI NË SEKTORIN E SIGURISË

Qytetarët u pyetën gjithashtu për perceptimin rreth korrupsionit në institucionet e sigurisë si Ushtria, Policia e Shtetit, SHISH dhe Doganat. Besimi mesatar ose i ulët ndaj këtyre institucioneve mund të lidhet me nivelet e larta të korrupsionit në institucionet e drejtësisë dhe të sigurisë.


Ndaj pyetjes “Sa i korruptuar mendoni ju se është ky institucion?”, 62.42% e qytetarëve mendojnë se Doganat janë shumë të korruptuara, 42.24% mendojnë të njëjtën përgjigje për Policinë e Shtetit, dhe 23.59% e qytetarëve mendojnë se SHISH është shumë i korruptuar. Për Ushtrinë vetëm 8.88% mendojnë se është shumë e korruptuar.

Korrupsioni në agjencitë me detyrën e ofrimit të sigurisë



Grafik 55. Rezultatet mbi perceptimin lidhur me korrupsionin në agjencitë e ofrimit të sigurisë

Qytetarët identifikuan institucionet e drejtësisë si institucionet më të korruptuara. 71.21% u shprehën që gjykatat janë shumë të korruptuara, dhe 66.91% u shprehën njësoj për Prokurorinë.



Grafik 56. Rezultatet mbi perceptimin lidhur me korrupsionin në institucionet e drejtësisë

ANEKSI 1 – PYETËSORI I ANKETËS

1- Sa vjeç jeni?

18-34

35-49

50-64

65 e sipër

2- Gjinia?

Mashkull

Femër

3- Cilës etni i përkisni?

Shqiptare

Greke

Maqedonase

Arumune

Tjetër

4- Ç'arsim keni?

0-9 vjet arsim

Të mesëm

Të lartë

Pasuniversitar

5- Ç'punë bëni?

Punëtor

Fermer

Nëpunës publik

Vetëpunësuar/menaxher

Arsim/mjeksi

Pensionist/e

I/e papunë

Nxënës/student

6- Vendi juaj i punës është në:

Qytet?

Rrethinat e qytetit?

Fshat?

Nuk punoj

7- Sa të sigurt e ndjeni veten në lagjen/fshatin ku punoni?

Shumë të sigurt
Të sigurt
Disi të sigurt
Jo të sigurt
Shumë të pasigurt
Nuk punoj

8- Ju banoni në:

Qytet?
Rrethinat e qytetit?
Fshat?

9- Sa të sigurt e ndjeni veten në lagjen/fshatin ku banoni?

Shumë të sigurt
Të sigurt
Disi të sigurt
Jo të sigurt
Shumë të pasigurt

10- Cili është kërcënimi numër 1 për sigurinë tuaj personale?

Vjedhjet
Grabitjet
Vandalizmi
Vrasjet
Konfliktet për pronën
Dhuna në familje
Veprimtaria e krimit të organizuar
Asnjë

11- Cili është kërcënimi numër 2 për sigurinë tuaj personale?

Vjedhjet
Grabitjet
Vandalizmi
Vrasjet
Konfliktet për pronën
Dhuna në familje
Veprimtaria e krimit të organizuar
Asnjë

12- Cili është kërcënimi numër një për sigurinë e Shqipërisë?

Lufta me vende fqinje
Terrorizmi
Ekstremizmi i dhunshëm
Krimi i organizuar

Korrupsioni
Emigrantët e huaj
Ndotja e mjedisit
Papunësia si fenomen (jo si problem personal)

13- Cili është kërcënimi numër dy për sigurinë e Shqipërisë?

Lufta me fqinjët
Terrorizmi
Ekstremizmi i dhunshëm
Krimi i organizuar
Korrupsioni
Emigrantët e huaj
Ndotja e mjedisit
Papunësia si fenomen (jo si problem personal)

14- Cili është kërcënimi numër një për sigurinë në Ballkan?

Lufta mes shteteve
Terrorizmi
Ekstremizmi i dhunshëm
Krimi i organizuar
Korrupsioni
Emigrantët nga jashtë
Përkeqësimi i mjedisit

15- Cili është kërcënimi numër dy për sigurinë në Ballkan?

Lufta mes shteteve
Terrorizmi
Ekstremizmi i dhunshëm
Krimi i organizuar
Korrupsioni
Emigrantët nga jashtë
Përkeqësimi i mjedisit

16- Cili është kërcënimi numër një për sigurinë në botë?

Lufta mes shteteve
Terrorizmi
Ekstremizmi i dhunshëm
Krimi i organizuar
Krimi kibernetik
Korrupsioni
Emigracioni masiv
Përkeqësimi i mjedisit
S'e di

17- Cili është kërcënimi numër dy për sigurinë në botë?

Lufta mes shteteve

Terrorizmi
Ekstremizmi i dhunshëm
Krimi i organizuar
Krimi kibernetik
Korrupsioni
Emigracioni masiv
Përkeqësimi i mjedisit
S'e di

18- A janë marrëdhëniet mes shteteve ballkanike më mirë se para një viti?

Jo
Ndoshta jo
Ndoshta po
Po
S'e di

19- Cili është vendi numër një më miqësor me Shqipërinë?

SHBA
Gjermania
Italia
Turqia
Franca
Austria
Maqedonia
Tjetër
S'e di

20- Cili është vendi i dytë më miqësor me Shqipërinë?

SHBA
Gjermania
Italia
Turqia
Franca
Austria
Maqedonia
Tjetër
S'e di

21- Cili është vendi i tretë më miqësor me Shqipërinë?

SHBA
Gjermania
Italia
Turqia
Franca
Austria
Maqedonia

Tjetër
S'e di

22- Si është ndikimi i NATO-s në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

23- Si është ndikimi i BE-së në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

24- Si është ndikimi i SHBA- së në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

25- Si është ndikimi i Gjermanisë në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

26- Si është ndikimi i Turqisë në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

27- Si është ndikimi i Rosisë në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv

Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

28- Si është ndikimi i Kinës në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

29- Si është ndikimi i Iranit në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

30- Si është ndikimi i vendeve arabe në sigurinë e vendit tonë?

Shumë pozitiv
Pozitiv
Neutral
Negativ
Shumë negativ
S'e di

31- Çfarë do t'ju bënte të ndiheshit më i sigurt?

Një ushtri më e fuqishme
Më shumë policë në terren
Organizimi i komunitetit
S'e di

32- Cili nga këto luan rolin më të rëndësishëm për sigurinë tuaj të përditshme?

Policia e shtetit
Policia bashkiake
Policinë private
Administratori i pallatit
Kryeplaku
Përfaqësuesi i komunitetit
Vetja juaj
Tjetër

33- A është mjaftueshëm e pranishme policia në lagjen/fshatin tuaj?

- Po
- Disi
- Jo
- S'e di

34- Sa i/e kënaqur jeni me situatën e sigurisë në lagjen/fshatin tuaj?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak
- S'e di

35- Sa i/e kënaqur jeni me bashkëpunimin mes qeverisë lokale dhe policisë për garantimin e sigurisë publike?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak
- S'e di

36- A mendoni se shteti do ta fitojë luftën me krimin e organizuar?

- Po
- Jo
- S'e di

37- Për sa vite mund ta fitojë shteti luftën me krimin e organizuar?

5 vite

- 10 vite
- 15 vite
- 20 vite
- Kurrë

38- Sa i/e kënaqur jeni me kontributin e ushtrisë shqiptare në sigurinë e vendit?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak
- S'e di

39- Sa kontribuojnë shërbimet sekrete shqiptare në sigurinë e vendit?

- Shumë
- Disi
- Pak
- Aspak

S'e di

40- Sa i kënaqur jeni me luftën e shtetit ndaj krimit të organizuar?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

41- Sa ndikon prezenca e policisë në terren për rritjen e sigurisë?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

42- Sa mendoni se do ta rriste sigurinë modernizimi i mëtejshëm i policisë?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

43- Sa mendoni se do ta rriste sigurinë shtimi i numrit të policisë?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

44- Si do të jetë situata e përgjithshme e sigurisë në 12 muajt e ardhshëm?

Më e mirë

Njësoj

Më keq

S'e di

45- A i respekton të drejtat e njeriut policia në punën e saj?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

46- Sa besim keni tek qeveria në përmirësimin e sigurisë?

Shumë

Disi

Pak
Aspak
S'e di

47- Sa besim keni tek Ministria e Mbrojtjes?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

48- Sa besim keni tek Ministria e Brendshme?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

49- Sa besim keni tek ushtria?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

50- Sa besim keni tek Policia e Shtetit?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

51- Sa besim keni tek Shërbimi i Zjarrfikseve?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

52- Sa besim keni tek SHISH-i?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

53- Sa besim keni tek Prokuroria?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

54- Sa besim keni tek Gjykatat?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

55- Sa besim keni tek policitë private?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

56- A i trajton Policia e Shtetit të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë?

Po
Jo
S'e di

57- Me krijimin e SPAK-ut, sa do të forcohet lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

58- Sa e korruptuar mendoni se është ushtria?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

59- Sa e korruptuar mendoni se është Policia e Shtetit?

Shumë
Disi
Pak
Aspak

S'e di

60- Sa i korruptuar mendoni se është SHISH-i?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

61- Sa e korruptuar mendoni se është Prokuroria?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

62- Sa të korruptuara mendoni se janë gjykatat?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

63- Sa e korruptuar mendoni se është Dogana?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

64- Sa e pavarur nga ndikimi politik është Ushtria?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

65- Sa e pavarur nga ndikimi politik është Policia e Shtetit?

Shumë

Disi

Pak

Aspak

S'e di

64- Sa i pavarur nga ndikimi politik është SHISH-i?

Shumë

Disi
Pak
Aspak
S'e di

67- Sa e pavarur nga ndikimi politik është Prokuroria?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

68- Sa të pavarura nga ndikimi politik janë gjykatat?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

69- Sa e pavarur nga ndikimi politik është Dogana?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

70- Sa të efektshme do të jenë gjykatat ndaj korrupsionit e krimit pas reformës në drejtësi?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

71- Sa mendoni se është i përhapur korrupsioni në prokurimet/tenderat në institucionet e sigurisë?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

72- Sa njerëz punësohen në administratën shtetërore vetëm në bazë të meritës dhe aftësive?

Të gjithë
Shumica

Pakica
Asnjë
S'e di

73- Sa njerëz punësohen në institucionet e sigurisë vetëm në bazë të meritës dhe aftësive?

Të gjithë
Shumica
Pakica
Asnjë
S'e di

74- Sa mendoni se është efektiv kontrolli i parlamentit mbi institucionet e sigurisë?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

75- Sa mendoni se duhet të forcohet kontrolli i parlamentit mbi institucionet e sigurisë

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

76- Sa e pengon situata e korrupsionit dhe krimit të organizuar integrimin e Shqipërisë në BE?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

77- Sa do të përmirësohet situata e sigurisë në Shqipëri pas anëtarësimit në BE?

Shumë
Disi
Pak
Aspak
S'e di

78- Pas sa vitesh mund të bëhet Shqipëria anëtare e plotë e BE-së?

5 vite

10 vite
15 vite
20 vite
Asnjëherë
S'e di

79- Bashkia ku jeton personi që u përgjigj

80- Emri i anketuesit

ANEKSI 2 – SHPËRNDARJA E KAMPIONIT NË 61 BASHKITË

	Bashkia	Frekuenca	Përqindja
1.	Belsh	7	0.63
2.	Berat	24	2.15
3.	Bulqizë	11	0.99
4.	Cerrik	11	0.99
5.	Delvinë	4	0.36
6.	Devoll	13	1.17
7.	Divjakë	15	1.35
8.	Dropull	4	0.36
9.	Durrës	67	6.01
10.	Elbasan	54	4.84
11.	Fier	50	4.48
12.	Finiq	6	0.54
13.	Fushë-Arrëz	3	0.27
14.	Gjirokastrë	14	1.26
15.	Gramsh	10	0.9
16.	Has	7	0.63
17.	Himarë	5	0.45
18.	Kamëz	32	2.87
19.	Kavajë	17	1.52
20.	Këlcyrë	3	0.27
21.	Klos	6	0.54
22.	Kolonjë	6	0.54
23.	Konispol	3	0.18
24.	Korçë	34	3.05
25.	Krujë	22	1.97
26.	Kuçovë	14	1.26
27.	Kukës	17	1.52
28.	Kurbini	17	1.52
29.	Lezhë	25	2.24
30.	Libohovë	2	0.18
31.	Librazhd	11	0.99
32.	Lushnjë	34	3.05
33.	Malësi e Madhe	12	1.08
34.	Maliq	17	1.52
35.	Mallakastër	11	0.99

36.	Mat	11	0.99
37.	Memaliaj	5	0.45
38.	Mirditë	10	0.9
39.	Patos	12	1.08
40.	Peqin	10	0.9
41.	Përmet	5	0.45
42.	Peshkopi	21	1.88
43.	Pogradec	24	2.15
44.	Poliçan	5	0.45
45.	Prrenjas	9	0.81
46.	Pukë	5	0.45
47.	Pustec	2	0.18
48.	Roskovec	9	0.81
49.	Rrogozhinë	9	0.81
50.	Sarandë	10	0.9
51.	Selenicë	8	0.72
52.	Shijak	10	0.9
53.	Shkodër	47	4.22
54.	Skrapar	5	0.45
55.	Tepelenë	4	0.36
56.	Tiranë	221	19.82
57.	Tropojë	8	0.72
58.	Ura Vajgurore	10	0.9
59.	Vau i Dejës	14	1.35
60.	Vlorë	43	3.86
61.	Vorë	10	0.9
	Total	1,115	100

BAROMETRI I SIGURISË SHQIPËRI ANKETË KOMBËTARE



Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

**FRIEDRICH
EBERT**

STIFTUNG